



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 31.3.2023

Nr: 228

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË “PARTISË SË GJELBËR”, PËR DISA BASHKI, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 31.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

- KËRKUES:** “Partia e Gjelbër” me shkronja nistore “ P.Gj”
- OBJEKTI:** Miratimi i listave shumemërore të “Partia e Gjelbër”, për disa bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 106, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Partia e Gjelbër” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 31.3.2023 Nr: 228
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listave shumemërore të “Partisë së Gjelbër”, për disa bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Në mbështetje të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “Partia e Gjelbër” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për bashkitë, Elbasan, Lezhë dhe Korçë, të subjektit zgjedhor “Partia e Gjelbër” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkitë Elbasan, Lezhë dhe Korçë, të subjektit zgjedhor të partisë “Partia e Gjelbër”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listave shumemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit elektronik. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, dhe përkatësisht për bashkitë: Elbasan, Lezhë dhe Korçë, të subjektit zgjedhor të partisë “Partia e Gjelbër”, sipas së cilës rezulton se:

1. Kandidatët e propozuar nga “Partia e Gjelbër”, në listën shumemërore për këshillin bashkiak **Elbasan** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015, pasi rezultojnë të jenë të padënuar.
2. Kandidatët e propozuar nga “Partia e Gjelbër”, në listën shumemërore për këshillin bashkiak **Lezhë** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015, pasi rezultojnë të jenë të padënuar.
3. Kandidatët e propozuar nga “Partia e Gjelbër”, në listën shumemërore për këshillin bashkiak **Korçë** (sipas lidhjes nr. 1) nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015, pasi rezultojnë të jenë të padënuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkitë Elbasan, Lezhë dhe Korçë, të subjektit zgjedhor “Partia e Gjelbër”. Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i

ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor “Partia e Gjelbër”, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të partisë “Partia e Gjelbër”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr.1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në Bashkitë Elbasan, Lezhë dhe Korçë, të “Partisë së Gjelbër”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Partia e Gjelbër**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Indrit	Hasan	Abdiaj	03/07/1978	M
2	Gentjana	Luan	Rama	11/01/2005	F
3	Tahsim	Myrteza	Dylgjeri	09/03/1971	M
4	Dafina	Gani	Tanushi	25/10/1992	F
5	Hyqmet	Musa	Xhafa	01/12/1968	M
6	Dorina	Nizamedin	Hysa	29/04/1985	F
7	Klevis	Dalip	Bahja	10/12/1997	M
8	Klarisa	Fatos	Tollumi	18/04/2000	F
9	Ylli	Shefqet	Rama	14/05/1993	M
10	Xhorxhina	Agim	Roçi	23/04/1993	F
11	Aldo	Eduart	Palloshi	13/05/2000	M
12	Isra	Ramiz	Pisha	12/04/2002	F
13	Luis	Apostol	Xheka	22/04/2001	M
14	Donsila	Pullumb	Bici	23/05/1988	F
15	Igli	Hyqmet	Harja	06/02/2001	M
16	Stela	Sami	Rusta	17/05/1994	F
17	Elvis	Enver	Likrama	14/08/1998	M
18	Romina	Astrit	Graba	19/10/1997	F
19	Emanuel	Lulzim	Abdiaj	05/05/2002	M
20	Xhensila	Arben	Shahinaj	17/10/2003	F
21	Rejan	Nderim	Serica	30/10/1999	M
22	Juana	Vait	Gjini	16/01/1997	F
23	Daniele	Vegim	Dishani	22/03/1999	M
24	Oltionisa	Tafil	Xhafa	22/06/2004	F
25	Geri	Arben	Selimaj	20/07/1999	M
26	Bukurie	Shaban	Biçaku	20/03/1994	F
27	Edison	Eduart	Dushku	05/04/2000	M
28	Adijesa	Avdi	Ruçi	26/08/1996	F
29	Ervin	Haqif	Rama	02/09/1999	M
30	Ersja	Ermanto	Zhika	28/12/2002	F
31	Lutfi	Selman	Metoshi	01/04/1972	M
32	Elena	Durim	Asllani	15/01/2004	F
33	Jani	Dashamir	Albrahimi	06/12/2002	M
34	Armela	Fatmir	Myrta	14/03/1997	F
35	Osman	Xhevahir	Gjokpali	12/05/2004	M
36	Anisa	Dalip	Kurti	19/06/2003	F



Partia e Gjelbër**Bashkia Elbasan****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Viktor	Harif	Pisha	05/12/1994	M
38	Fabiola	Arben	Shahinaj	08/02/2001	F
39	Fabio	Vegim	Dishani	16/02/2001	M
40	Darlina	Zaim	Beqiri	04/09/2001	F
41	Denis	Xhevahir	Sula	22/08/2002	M
42	Uajda	Adrian	Xhafka	31/03/2001	F
43	Oltian	Shyqyri	Dybeli	20/11/1996	M
44	Oriana	Agron	Dushku	16/06/2002	F
45	Maksim	Haxhi	Tahirja	30/06/1981	M
46	Sara	Ilir	Ranxha	26/02/2001	F
47	Petrit	Rexhep	Rama	05/04/1986	M
48	Egliseida	Edmond	Myftaraj	16/07/2004	F
49	Altin	Shaban	Ruçi	20/11/1990	M
50	Eva	Kundret	Bica	18/09/2002	F
51	Përparim	Dylaver	Rama	27/08/1978	M
52	Eda	Selman	Kusi	13/10/2004	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

52

Partia e Gjelbër
Bashkia Korçë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Xhino	Lulëzim	Isak	13/04/1997	M
2	Enduela	Seit	Beqiraj	16/04/1990	F
3	Dritan	Albert	Bilbili	11/12/1978	M
4	Englantina	Gëzim	Arifi	27/11/1983	F
5	Erando	Koço	Myftarago	31/10/1987	M
6	Irisa	Arben	Isak	11/12/1996	F
7	Marjon	Pëllump	Tola	06/01/1993	M
8	Avdina	Kristo	Bilbili	13/01/1982	F
9	Damjan	Arjan	Maliqi	04/06/2004	M
10	Alba	Astrit	Myftarago	25/08/1994	F
11	Sade	Andon	Biraku	18/10/2000	M
12	Merjem	Gentian	Rushiti	26/11/2003	F
13	Xhuljano	Petrit	Lamo	24/10/1996	M
14	Matilda	Alfredi	Sulejmani	12/02/2001	F
15	Dejvi	Niko	Hanelli	10/06/1994	M
16	Artiola	Çelnik	Lamo	28/01/1997	F
17	Denis	Lulëzim	Isak	03/02/2001	M
18	Maria	Aurel	Karafili	12/08/2002	F
19	Sildi	Mitat	Hasankolli	28/07/2000	M
20	Ina	NIKO	Bujari	18/07/1994	F
21	Unejs	Renato	Liço	30/12/2004	M
22	Vangjelina	Artur	Yzeir	09/12/1996	F
23	Lizert	Ermir	Liço	15/01/2002	M
24	Maria	Petraç	Thëngjilli	13/06/2000	F
25	Renato	Napolon	Liço	18/09/1976	M
26	Anila	Agim	Liço	13/12/1978	F
27	Albert	Dritan	Bilbili	15/09/2004	M
28	Ronilda	Arben	Ogrenaj	21/01/1999	F
29	Elkend	Barjam	Spahiu	26/07/1997	M
30	Erinda	Robert	Çekrezi	01/08/1997	F
31	Martin	Nexhip	Dervishi	09/06/1989	M
32	Voltisa	Yzedin	Rrezhda	16/10/1994	F
33	Bledar	Durim	Beqiraj	29/04/1985	M
34	Zhaneta	Sheme	Bregasi	27/12/1977	F
35	Erion	Agim	Arifi	22/01/1982	M
36	Ruberta	Kalem	Myrtollari	17/12/2000	F



Partia e Gjelbër
Bashkia Korçë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Klodian	Tomor	Guçe	21/02/2004	M
38	Marjana	Vangjel	Yzeir	25/03/1967	F
39	Sandri	Shkëlqim	Zavalani	03/05/2004	M
40	Liza	Esat	Berlat	23/08/1991	F
41	Ernest	Arben	Bilbili	23/10/1996	M
42	Kamela	Andrea	Bode	04/07/1989	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

42



Partia e Gjelbër
Bashkia Lezhë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Brahim	Osman	Demi	29/04/1994	M
2	Elodia	Kadri	Mali	22/04/1990	F
3	Emirjon	Alfred	Mali	20/10/1987	M
4	Bardhe	Ndue	Doda	01/01/1973	F
5	Zek	Gjon	Doda	18/07/1968	M
6	Rubina	Kujtim	Haxhia	18/07/2000	F
7	Seladin	Arif	Muça	10/03/1966	M
8	Marjana	Zef	Canga	01/10/1976	F
9	Anton	Gjergj	Luci	24/10/1993	M
10	Reandra	Shaqir	Bitri	14/09/2000	F
11	Kristian	Fran	Ndoca	26/05/2001	M
12	Liserda	Ded	Çuni	08/06/1998	F
13	Zyber	Fiqiri	Mziu	01/11/1986	M
14	Eglantina	Rexhep	Pjetri	02/08/1990	F
15	Dritan	Bib	Nikolli	28/10/1994	M
16	Sabina	Kujtim	Demi	10/11/1995	F
17	Taulant	Metush	Mergjyli	13/09/1973	M
18	Manjola	Prend	Ndoci	12/12/1988	F
19	Artur	Zeqir	Bahidi	15/06/1963	M
20	Marjeta	Mark	Vokrri	25/09/1981	F
21	Igli	Selim	Malecaj	20/02/1999	M
22	Vida	Ndue	Perdedaj	02/06/1985	F
23	Emiljano	Gasper	Toma	02/04/1987	M
24	Vjollca	Tafil	Haxhia	12/05/1974	F
25	Jetmir	Nikoll	Keçi	28/04/1992	M
26	Hanë	Brahim	Malecaj	10/05/1965	F
27	Elson	Osman	Demi	06/05/1990	M
28	Arjola	Nik	Keçi	22/04/1998	F
29	Ervin	Frrok	Pjetri	12/01/1995	M
30	Marinela	Paulin	Leka	28/08/1996	F
31	Anton	Fran	Martini	08/04/1993	M
32	Lireta	Pjetër	Çuni	19/03/1975	F
33	Osman	Brahim	Demi	14/11/1958	M
34	Sidorela	Tonin	Luci	21/01/1995	F
35	Kujtim	Asllan	Haxhia	16/04/1965	M
36	Doris	Ded	Çuni	21/10/1995	F



Partia e Gjelbër
Bashkia Lezhë

Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Bajram	Islam	Dembacaj	31/05/1961	M
38	Sebije	Brahim	Curaj	24/04/1962	F
39	Aziz	Abdyl	Rexha	16/06/1943	M
40	Shere	Isuf	Haxhia	27/05/1962	F
41	Denis	Ded	Çuni	14/08/2003	M
42	Xhevahire	Islam	Demi	01/04/1960	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

42

